



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

P.A.nr.5/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Faton Ademi anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Drilona Kajtazi, në çështjen juridike të konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit: Këshilli Drejtues i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Xhavit Ahmeti”, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. N., anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës “Xhavit Ahmeti”, kundër të paditurave: Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hazbije Selimi, Avokate shtetërore nga Ministria e Drejtësisë, me bazë juridike: shfuqizimi i aktit nënligjor normativ, përkatësisht dispozitës së veçantë të tij nga neni 21 të Rregullores nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Para universitar, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve ndërgjyqëse, më datë 23 prill 2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditësit Këshilli Drejtues i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Xhavit Ahmeti”, me seli në Prishtinë.

II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet neni 21 i Rregullores Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Para universitar, të Qeverisë së

Republikës së Kosovës, e miratuar me vendimin Nr. 03/212, të datës 10.07.2024, si dhe e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me datë 25.07.2024.

III. Refuzohet kërkesa për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit parashtuar nga paditësi: Këshilli Drejtues i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Xhavit Ahmeti”, me seli në Prishtinë, përmes të cilës ka kërkuar ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të Rregullores Nr.19/2024, konkretisht neni 21 i kësaj rregulloreje.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

V. Ky aktgjykim merr formën e prerë menjëherë pas komunikimit të përmbajtjes dhe arsyetimit të tij palëve, dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

I. Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi Këshilli Drejtues i SHFMU “Xhavit Ahmeti”, me seli në Prishtinë më datë 03.03.2026, në Gjykatën Supreme të Kosovës, ka parashtuar padi me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër të paditurave Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me seli në Prishtinë, për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, përkatësisht dispozitës së veçantë të tij nga neni 21 të Rregullores nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Para universitar, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 25.07.2024.

Paditësi, me padi, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që të shpall të paligjshëm dhe të shfuqizoj nenin 21 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024. Paditësi ka theksuar se kemi bërë kërkesa të vazhdueshme që Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit të veprojnë në baze të ligjit dhe ta plotësojnë ndryshojnë rregulloren Nr. 19/2024, pa pasur nevojë që të jemi në kontest gjyqësor, sepse Qeveria e RKS,

konkretisht Zyra e Kryeministrit i është përgjigjur këshillit drejtues shumë herë, disa janë të paraqitura edhe në kërkesëpadi, ato më relevante, ka shqyrtuar paraprakisht kërkesat tona dhe ka kërkuar nga MASHT që të bëjnë rishikimin e nenit 21 të rregullores së atakuar, me qëllim të harmonizimit të saj me Ligjin Nr. 04 L-032 për Arsimin Parauniversitar, dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03/16 për Kompetencat e Këshillit të Shkollës, megjithatë MASHT nuk ka vepruar dhe ka shpërfillur edhe institucionin me të lartë që duhet ti përgjigjet. Paditësi pastaj ka theksuar se Gjykata Supreme, me aktgjykimin PA.nr.34/2025, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses Komuna e Gjakovës lidhur me këtë rregullore, vendim ky i cili është tërësisht ligjor edhe i standardeve juridike, pasi e ka shpjeguar hierarkinë e ligjeve, normat e përgjithshme dhe të veçanta dhe kur këto dispozita janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Pra Gjykata Supreme mban qëndrimin e njëjtë me Këshillin drejtues të shkollës “Xhavit Ahmeti”, pasi që ligji i veçantë, ai i Arsimit e mbizotëron Ligjin e zyrtarëve publik si ligj i përgjithshëm, dhe ka shpjeguar se komisioni vlerësues duhet të bazohet në nenin 35, paragraf 4 të Ligjit 04 L-032. Paditësi ka konsideruar se Gjykata Supreme në këtë rast me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e Komunës së Gjakovës, pasi kërkesa ka qenë për politizimin e konkursit edhe me tutje përtej Rregullores së Qeverisë, duke kërkuar që konkursi dhe komisioni të udhëhiqen nga burimet njerëzore, të përjashtohet DKA, sepse burimet njerëzore i përgjigjen drejtpërdrejtë Kryetarit të Komunës. Andaj Qeveria e RKS me këtë provë që e ka paraqitë si praktikë gjyqësore i ka hequr të gjitha dilemat, por ky rast nuk është rast i gjykuar pasi që kërkesat janë të ndryshme dhe palët po ashtu të ndryshme në këtë procedurë, me pretendim se Gjykata Supreme sipas paditëses duhet të gjykoj njëjtë dhe ti vlerësoj parimet si në aktgjykimin PA.nr.34/2025.

Më tej ka shtuar se Avokatura Shtetërore, por nuk pat asnjë sqarim se pse e paditura e dytë MASHT nuk ka vepruar sipas Qeverisë së RKS - Zyrës së Kryeministrit, për ta harmonizuar këtë rregullore sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar si ligj special dhe i veçantë, i cili i mbizotëron të gjitha ligjet tjera, dhe po të ndodhte kjo pasojat në të ardhmen do të ishin më të vogla, pasi që ky nen patjetër që duhet të shpallet i jashtëligjshëm dhe të harmonizohet me Ligjin e Arsimit Parauniversitar, ashtu siç ceket në preambulën e kësaj rregulloreje, por realisht nuk kanë vepruar sipas preambulës. Në rast se komisionet kanë qenë të paligjshme të gjitha veprimet e atij komisioni janë të paligjshme dhe produkti i atij komisioni është i paligjshëm, përzgjedhja e stafit arsimor është e paligjshme. Në fund ka theksuar se masa e përkohshme është e domosdoshme, e nevojshme sepse edhe në këto momente janë duke vepruar me komisione të paligjshme, kjo cenon edhe sigurinë e publike, pasi që bëhet fjalë për nxënësit tonë, për mësimmshënësit e tyre që zgjedhën në procedurën e rekrutimit nga një komision i paligjshëm, ku në praktikë që ne e përjetojmë si këshill drejtues çdo ditë, është e çuditshme se çka është duke ndodhë. Ka propozuar që pas administrimit të provave të aprovohet propozimi për vendosjen e masës së përkohshme dhe të

ndalohet prodhimi i efekteve juridike të kësaj rregulloreje deri në kohën kur të paditurat ta harmonizojnë këtë rregullore me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, përndryshe të paditurat kanë dhënë shembull se nuk do të veprojnë pa pasur një vendim nga gjykata. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pasi ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 23.04.2026, e ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të Ligji Nr. 08/L-182 Për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 10 Janar 2024, Prishtinë, (tutje: LKA-së), në praninë e palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës me përgjigje në padi, dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të refuzoj kërkesëpadinë e paditëses për shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimit të nenit 21 aktit nënligjor normativ. Përfaqësuesi i të paditurës në gjykatë ka theksuar se mbetemi në tërësi si në përgjigjen në padi të datës 19.03.2026, duke ritheksuar faktin se e paditura e konteston në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesën e saj, për faktin se Rregullorja Nr.19/2024 bazohet në mbështetje të plotë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera të cekura në padi. Tutje ka shtuar se ky akt nënligjor i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore të parapara dhe është aprovuar si i ligjshëm nga Ministria Përgjegjëse për Administratën Publike, dhe është proceduar në ZKM për miratim duke konsideruar që rregullorja është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi. Pra padia dhe kërkesëpadia nuk kanë mbështetje dhe as qëndrueshmëri as në aspektin faktik dhe juridik, andaj mbi këtë bazë e paditura i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të bie aktgjykim me të cilin do ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, ashtu që rregulloren ta lë në fuqi.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

II. Vlerësimi i gjendjes faktike dhe provat e administruara

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave në seancën e shqyrtimit gjyqësor - publik të datës 23.04.2026, ka administruar provat relevante dhe atë: Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Parauniversitar, si dhe ka lexuar komunikimet me email të datës 20.08.2025, 21.08.2025, 26.09.2025 (dy emaila), 29.09.2025,

22.10.2025 (dy email), 30.10.2025, 04.11.2025, 06.11.2025 (dy email), 10.12.2025, 23.01.2026, 06.02.2026 dhe 09.02.2026.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 212-të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/212 të datës 10.07.2024, ka miratuar Rregulloren (QRK) - Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.

Aktin nënligjor normativ të kontestuar, e ka nxjerr në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 81 paragrafit 8, 82 paragrafit 4 dhe nenit 83 paragrafit 5 të Ligjit për Zyrtarët Publik, paragrafët (c) dhe (d) të nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 30 / 15 qershor 2008), të nenit 19 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 17/16, shtator 2011), nenit 2 të Ligjit nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neneve 15 dhe 17 të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, nenit 8 (4.5) Ligjit nr.08/117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe nenit 78 paragrafi 6, nënparagrafi 6.2 të Rregullores (QRK) Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kjo rregullore përcakton procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve, në të gjitha institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP) në tërë territorin e Kosovës.

Pas shqyrtimit të dispozitave të akteve nënligjore normative të kontestuara, Gjykata konstaton se dispozita kontestuese bie ndesh me parimet dhe dispozitat ligjore.

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, procedimit dhe vlerësimit të provave materiale të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, Gjykata konstaton se pretendimet e paditësit sipas padisë dhe kërkesës për caktimin e masës së përkohshme/posaçme të sigurimit janë vlerësuar të pabazuara.

III. Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 09.04.2008, dhe ka hyrë në fuqi më 15.06.2008

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]: “*Qeveria ka këto kompetenca: (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve*”.

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragraf 3 përcakton: “*Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*”.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare Nr.3, i miratuar më 14 dhjetor 2023, dhe në fuqi nga data 10 janar 2025

Neni 3 [Përkufizimet]: “*1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme*”.

Neni 5 [Parimi i ligjshmërisë]: “*Gjykata kompetente shqyrton konfliktin dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*”.

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca]: “*4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ*”.

Neni 11 [Përbërja në gjykim]: “*3. Gjykata Supreme, gjykon lëndën në kolegji të përbërë prej tre (3) gjyqtarësh*”.

Neni 13 [Llojet e padive]: “*1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”)*”.

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “*1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarimin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 4. Padia mund të ngrihet edhe nga një organ publik i autorizuar shprehimisht me ligj të veçantë dhe për rastet e parashikuara me atë ligj. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin. 7. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes së tij në fuqi*”.

Neni 59 [Procedimi i padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normative]: “8. Në shqyrtimin e themelësisë së padisë, Gjykata vlerëson përmbajtjen, formën dhe procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të aktit nënligjor normativ të kontestuar.”

Neni 99 [Masat e posaçme të sigurimit të padisë në konfliktet administrative]: “2. Për sigurimin e padisë në rastin e padive për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ administrativ, Gjykata me kërkesë, mund të vendosë për moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të aktit nënligjor normativ”.

Neni 100 [Kushtet për marrjen e masave të përkohshme të sigurisë]: “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin 17 publik”. 2. Për marrjen e masës së sigurisë të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 99 të këtij Ligji, Gjykata shqyrton plotësimin e kushteve të nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Ligji Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.21 / 18 Shtator 2023, Prishtinë

Neni 5 [Kategoritë e zyrtares/it publik]: “3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës.”

Neni 16 [Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore]: “1. Çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik në fushën e veprimit të këtij ligji, duhet të ketë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive. 3. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në nivelin komunal, i zhvillon procedurat për pranimin në punë për zyrtarët/ët publik në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”

Neni 65 [Transferimi i përhershëm për interes të institucionit]: “5. Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me

marrëveshje në mes të institucioneve. 7. Qeveria me akt nënligjor, me propozim të ministritë përgjegjëse për administratë publike miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.”

Neni 80 [Procedura e pranimit në shërbimin publik]: “4. Procedura e konkurrimit organizohet nga NjMBNj e organit emërues.”

Neni 81 [Procedura e rekrutimit]: “7. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë, Komisioni i përzgjedhjes është me mandat dy (2) vjeçar, themelohet nga organi emërues dhe përbëhet nga të paktën pesë (5) anëtare/ë. Komisioni i përzgjedhjes themelohet për çdo grup apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi. 8. Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse që mbulon shërbimin publik përkatës dhe pas pëlqimit të ministritë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.”

Neni 82 [Themelimi i marrëdhënies së punës]: “3. NjMBNj përgatit kontratën e punës, që nënshkruhet nga organi emërues dhe kandidatja/i fituese, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni. 4. Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse që mbulon shërbimin publik përkatës dhe pas pëlqimit të ministritë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.”

Neni 83 [Puna provuese]: “5. Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse që mbulon shërbimin publik përkatës dhe pas pëlqimit të ministritë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.”

Neni 86 [Transferimi dhe pezullimi i marrëdhënies së punës në shërbimin publik]: “1. Dispozitat e nenit 63, 64, 65 dhe 66 të këtij ligji zbatohen edhe për nëpunësen/i në shërbimit publik me rastin e transferimit të përkohshëm, të përhershëm apo me rastin e transferimit në rast të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.”

Ligji Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtaret Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 02 Qershor 2025, Prishtinë

Neni 15 Në nenin 88 të ligjit bazik, pas paragrafit 2.shtohet një paragraf 3. i ri si në vijim: 3. Ankesa sipas paragrafit 1. të këtij neni parashtrohet tek Komisioni i Ankesave i themeluar sipas nenit 27 të këtij ligji.

Ligji Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 30 / 15 Qershor 2008

Neni 5 [Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë) Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0

(parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i]; c) *punësimin e mësimitdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë*; d) *zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin e të dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtar do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHTI-i.*”

Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 Shtator 2011, Prishtinë

Neni 35 [Zgjedhja ose emërimi i drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve dhe instruktorëve]: “4. *Mësimitdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi. 8. Me akt nënligjor, Ministria duhet të përpilojë dispozita të tjera në përputhje me këtë ligj lidhur me emërimin e drejtorëve, zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, asistentëve dhe instruktorëve sipas këtë ligji, si dhe përgjegjësi të komunave dhe këshillave drejtuese.*”

Rregullore (QRK) Nr:19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimitdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 25.07.2024.

Neni 2 [Fushëveprimi]: “2. *Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjMBNj) e komunës përkatëse dhe Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në komunat e Republikës së Kosovës, MASHTI dhe AAPARr, janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare të komunës.*”

Neni 7 [Transferimi i mësimitdhënësve]: “7. *Në rastet e transferimit të mësimitdhënësve nga një komunë në tjetrën, me kërkesë të mësimitdhënësve, DKA-të, MASHTI, AAPARr, bëjnë marrëveshje me shkrim për transfer.*”

Neni 21 [Përbërja e komisionit përzgjedhës]:

“1. Procesi i përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor koordinohet dhe drejtohet nga NjMBNj e punëdhënësit në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Arsim në nivel komune, MASHTI-n për Qendrat Burimore dhe Agjencinë për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (në vijim AAAPARr).

2. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në nivel komune, Drejtoria Komunale e Arsimit nxjerr vendim për themelimin e Komisionit përzgjedhës, përfshirë edhe kryetarin/en e komisionit, i cili duhet të jetë zyrtar i DKA-së.

2.1. Komisioni përzgjedhës themelohet për çdo grup pozitash apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi.

2.2. Komisioni për përzgjedhjen e mësimdhënësve, ka përgjegjësi të intervistoj dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

3. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në Qendrat Burimore, MASHTI nxjerr vendim për themelimin e Komisionit përzgjedhës, përfshirë edhe kryetarin/en e komisionit, i cili duhet të jetë zyrtar i MASHTI.

3.1. Komisioni përzgjedhës themelohet për çdo grup pozitash apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi.

3.2. Komisioni për përzgjedhjen e mësimdhënësve, ka përgjegjësi të intervistoj dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

4. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në Qendrat e Kompetencës, AAAPARr nxjerr vendim për themelimin e Komisionit përzgjedhës, përfshirë edhe kryetarin/en e komisionit, i cili duhet të jetë zyrtar i AAAPARr-së.

4.1. Komisioni përzgjedhës themelohet për çdo grup pozitash apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi.

4.2. Komisioni për përzgjedhjen e mësimdhënësve, ka përgjegjësi të intervistoj dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

5. Në procedurën e emërimit të Komisionit, DKA, MASHTI dhe AAAPARr, shqyrtojnë nëse ndonjëri nga anëtarët e propozuar të komisionit ka një konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi me kandidatët/et që kanë konkurruar në pozitën/at e tilla.

5.1. Në një rast të tillë, DKA, MASHTI dhe AAAPARr, janë të detyruara që sipas detyrës zyrtare të eliminojë konfliktin e interesit duke e ndërruar sipas së njëjtës procedurë anëtarin/en që ka një status të tillë papajtueshmërie.

5.2. Pavarësisht vlerësimit nga DKA, MASHTI dhe AAAPARr, anëtarët e përzgjedhur në Komision duhet të vetëdeklarohen, përmes nënshkrimit të një dokumenti formular, nëse ata kanë ndonjë situatë papajtueshmërie me kandidatët që kanë konkurruar në konkursin që ata do e vlerësojnë.

6. Anëtarët e komisionit duhet të kenë së paku një kualifikim të barasvlershëm me kërkesat për pozitën e shpallur në konkurs.

7. Komisioni përzgjedhës është ad hoc. Mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtar/e për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me konkurs.

8. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në nivel komune, komisioni përzgjedhës përbëhet nga pesë anëtarë:

8.1. Një anëtar/e nga DKA nga radhët e zyrtarëve të arsimit në nivel komune, që i plotëson kërkesat e përcaktuara me pikat 5 dhe 6 të këtij neni dhe i/e cili/a është edhe kryetar i komisionit;

8.2. Një anëtar mësimdhënës i cili vjen nga fusha përkatës për pozitën e shpallur në konkurs, i emëruar nga DKA;

8.3. Një anëtar/e i/e nominuar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;

8.4. Një anëtar/e profesionist/e, i/e cili/a duhet të jetë ekspert i shquar i arsimit në fushën kurrikulare përkatëse, i emëruar nga DKA;

8.5. Njëri anëtar/e nominohet nga NjMBNj dhe i/e cili/a duhet të jetë ekspert/e i/e burimeve njerëzore.

9. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në Qendrat Burimore, komisioni përzgjedhës përbëhet nga pesë anëtarë:

9.1. Një anëtar/e nga MASHTI nga radhët e zyrtarëve të arsimit parauniversitar, që i plotëson kërkesat e përcaktuara me pikat 5 dhe 6 të këtij neni, dhe i/e cili/a është edhe kryetar/e i/e komisionit;

9.2. Një anëtar mësimdhënës i cili vjen nga fusha përkatëse për pozitën e shpallur në konkurs, i emëruar nga Qendra Burimore;

9.3. Një anëtar/e i/e nominuar nga Këshilli i Prindërve në nivel të Qendrës Burimore;

9.4. Një anëtar/e profesionist/e, i/e cili/a duhet të jetë ekspert i shquar i arsimit në fushën kurrikulare përkatëse, i emëruar nga MASHTI;

9.5. Njëri anëtar/e nominohet nga NjMBNj dhe duhet të jetë ekspert/eksperte i/e burimeve njerëzore.

10. Për përzgjedhjen e personelit edukativo-arsimor në Qendrat e Kompetencës, komisioni përzgjedhës përbëhet nga pesë anëtarë:

10.1. Një anëtar/e nga AAAPARr nga radhët e zyrtarëve që i plotëson kërkesat e përcaktuara me pikat 5 dhe 6 të këtij neni, dhe i/e cili/a është edhe kryetar i komisionit;

10.2. Një anëtar mësimdhënës i cili vjen nga fusha përkatëse për pozitën e shpallur në konkurs, i emëruar nga AAAPARr;

10.3. Një anëtar/e i/e nominuar nga Këshilli i Prindërve në nivel të Qendrës së Kompetencës;

10.4. Një anëtar/e profesionist/e, i/e cili/a duhet të jetë ekspert i shquar i arsimit në fushën kurrikulare përkatëse, i emëruar nga AAAPARr.

10.5. Njëri anëtar/e nominohet nga AAAPARr dhe i/e cili/a duhet të jetë ekspert/eksperte i/e burimeve njerëzore.

11. Asnjë nga anëtarët e komisionit përzgjedhës nuk mund të jenë persona që janë të angazhuar politikisht apo që kanë një pozitë udhëheqëse partiake dhe duhet të kenë të dëshmuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre partiake e politike.

12. Për të mbështetur punën e Komisionit përzgjedhës, MASHTI përgatitë Udhëzues të veçantë për administrimin dhe dokumentimin e procedurës së përzgjedhjes brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje”.

Neni 27 [Testi me shkrim]: “1. Testi me shkrim përgatitet nga Komisioni, varësisht nga profili i caktuar për të cilin shpallet konkursi.”

Neni 28 [Testi me gojë (intervista)]: “1. Komisioni përzgjedhës fton në testin me gojë/intervistë, pjesëmarrësit e testimit me shkrim të cilët kanë fituar 50% e më shumë të pikëve të testit me shkrim.”

Neni 34 [Udhëzuesi për administrim të procedurës së përzgjedhjes]: “MASHTI përgatitë Udhëzues të veçantë për zbatimin e kësaj Rregulloreje me shtojcat përkatëse për administrimin dhe dokumentimin e procedurës së përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve, zëvendës drejtorëve, mësime dhënëse, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në IEAA-AP.”

Neni 35 [Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj Rregulloreje]: “Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje e bëjnë Inspektorati i punës dhe Inspektorati i arsimit.”

Udhëzim Administrativ (Masht) Nr. 03 /2016 Këshilli Drejtues i Shkollës

Neni 10 [Këshillit drejtues në zgjedhjen e personelit të shkollës]: “1. Këshilli drejtues ka për detyrë ta zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësime dhënëse nga anëtarët e Këshillit drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe mësime dhënëse të shkollës”. 2. Të zgjedhurit nga paragrafi 1 i këtij neni e kanë rolin e vëzhguesit në këtë panel, mirëpo ata e japin mendimin e tyre për zgjedhjen e personelit mësime dhënëse dhe administrativ nga komisioni intervistues. 3. Nëse përfaqësuesit e Këshillit

drejtues të shkollës vërejnë se është bërë padrejtësi në zgjedhjen e personelit, ata duhet të njoftojnë KDSH mbi veprimet e komisionit intervistues”.

IV. Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ të kontestuar

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas nenit 59 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, ka shqyrtuar ligjshmërinë e Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 brenda kufijve të pretendimeve të ngritura nga paditësi dhe në raport me bazën ligjore mbi të cilën është nxjerrë akti i kontestuar.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet e paditëses lidhur me ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ të kontestuar, përkatësisht nenit 21 të tij, me Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, konkretisht vlerësimi nëse me këtë akt nënligjor janë tejkaluar kompetencat normative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe nëse dispozita e atakuar bie ndesh me parimin e hierarkisë së akteve juridike, sigurisë juridike në procedurat e përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor.

Nga përmbajtja e padisë dhe deklarimi në seancën e shqyrtimit gjyqësor rezulton se paditësi konteston nenin 21 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024, duke pretenduar se bie ndesh me nenin 35 paragraf 4 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, pasi që sipas ligjit procedurat e zgjedhjes ose emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve dhe instruktorëve, për mësimdhënësit përcaktohet se të njëjtit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor, si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi, ndërsa rregullorja e kontestuar parashikon se Procesi i përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor koordinohet dhe drejtohet nga NjMBNj e punëdhënësit në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Arsim në nivel komune, MASHTI-n për Qendrat Burimore dhe Agjencinë për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (në vijim AAAPARr), duke përjashtuar nga komisioni për përzgjedhjen e personelit edukativo - arsimor, drejtorin e institucionit arsimor, si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues.

V. Lidhur me kompetencën e Qeverisë për nxjerrjen e Rregullores

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe analizës së dispozitave relevante kushtetuese dhe ligjore, Gjykata Supreme vlerëson se Qeveria e Republikës së Kosovës ka pasur autorizim kushtetues dhe ligjor për nxjerrjen dhe miratimin e Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve

Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 25.07.2024. Pra me nxjerrjen e rregullores së lartcekur dhe duke marrë parasysh aspektin formal të kompetencës (kompetencës *ratione materiae* dhe *ratione auctoritatis*), Gjykata konstaton se Qeveria ka vepruar brenda autorizimeve kushtetuese dhe ligjore kur ka miratuar rregulloren e lartcekur. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se neni 93 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Qeveria nxjerr vendime dhe akte nënligjore për zbatimin e ligjeve. Ky autorizim kushtetues përbën bazën e përgjithshme normative mbi të cilën Qeveria ushtron kompetencën e saj rregullatore, gjithmonë në funksion të zbatimit, konkretizimit dhe operacionalizimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

Po ashtu, Gjykata konstaton se rregullorja e kontestuar është nxjerrë në përputhje me autorizimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, përkatësisht nenin 81 paragrafi 8, nenin 82 paragrafi 4 dhe nenin 83 paragrafi 5, si dhe nenin 35 paragrafi 8 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, të cilat parashohin nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin e procedurave të rekrutimit, themelimit të marrëdhënies së punës dhe punës provuese. Këto dispozita përbëjnë autorizim të qartë dhe specifik për rregullimin e këtyre çështjeve nëpërmjet akteve nënligjore, përfshirë edhe në sektorin e arsimit.

Gjykata vlerëson se, ndonëse ekziston një bazë e qartë ligjore që mundëson nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e Qeverisë në këtë fushë, kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me dispozitat e ligjeve në fuqi, marrë për bazë faktin se aktet nënligjore duhet të jenë në funksion të zbatimit të ligjit dhe nuk mund të ndryshojnë, kufizojnë apo tejkalojnë dispozitat ligjore. Pra paragraf 4 i nenit 35 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar ka përcaktuar në mënyrë të qartë se mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor, si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi, që në këtë rast rregullorja e atakuar, konkretisht neni 21 i saj, rezulton se është në kundërshtim me nenin 35 paragraf 4 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Gjykata me rastin e vendosjes së ligjshmërisë së rregullores së lartcekur, respektivisht nenit 21 të saj, ka marrë parasysh nenin 35 paragraf 8 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i cili obligon nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin më të detajuar të procedurave të emërimit të personelit arsimor. Megjithatë, Gjykata vëren se paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton qartë procedurën e përzgjedhjes së mësimdhënësve, sipas së cilës ata

përzgjidhen nga një komision i themeluar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, me përfshirjen e drejtorit të institucionit arsimor dhe përfaqësuesve të këshillit drejtues. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se dispozitat e Rregullores, përkatësisht neni 21 i saj, devijojnë nga kjo procedurë e përcaktuar me ligj, duke krijuar një rregullim që nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Përveç kësaj, Gjykata ka vlerësuar se Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës me nenin 5 paragrafi (c) dhe (d) të tij, u njeh komunave kompetenca në fushën e punësimit dhe përzgjedhjes së personelit arsimor, mirëpo ushtrimi i këtyre kompetencave është i kushtëzuar me respektimin e procedurave dhe standardeve të përcaktuara me legjislacionin qendror. Prandaj, në këtë rast Gjykata thekson se në pjesën që rregullorja bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Arsimin Parauniversitar (nenin 21 të saj), ajo është nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit që ekziston një ndërthurje e qartë normative ndërmjet Ligjit për Zyrtarët Publik dhe ligjeve sektoriale të arsimit, të cilat së bashku krijojnë bazë të mjaftueshme ligjore për nxjerrjen e një akti nënligjor nga ana e Qeverisë që rregullon procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese, mirëpo kjo nuk nënkupton se Qeveria me nxjerrjen e rregullores së tillë ka kompetencë të tejkaloj dispozitat e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, respektivisht të nxjerrë rregulloren në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, (në rastet e zgjedhjes së personelit arsimor, respektivisht mësimdhënësve) siç ka vepruar në këtë rast.

VI. Lidhur me pretendimet për komisionet përzgjedhëse.

Paditësja pretendon se neni 21 i Rregullores Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo - Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Para universitar, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bie ndesh me nenin 35 paragraf 4 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i cili parasheh se mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor, si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi.

Gjykata, në shqyrtimin e këtij pretendimi, fillimisht i referohet dispozitave përkatëse të Ligjit për Zyrtarët Publik, përkatësisht Nenit 16 paragrafi 3 përcakton: *“Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në nivelin komunal, i zhvillon procedurat për pranimin në punë për zyrtaret/ët publik në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”* Ndërsa neni 80 paragrafi 4 përcakton: *“Procedura e konkurrimit organizohet nga NjMBNJ e organit emërues.”* Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se NjMBNJ ka rol qendror në organizimin dhe zhvillimin e procedurave të pranimit në shërbimin publik. Megjithatë, këto dispozita duhet të interpretohen në kontekstin e tërësisë së sistemit normativ dhe në ndërthurje me legjislacionin sektorial. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, konkretisht nenit 35 paragrafi 4, i cili përcakton: *“Mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi.”* Kjo dispozitë, si normë sektoriale specifike në fushën e arsimit, parasheh qartë një rol aktiv të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në themelimin e komisionit përzgjedhës për mësimdhënësit. Për rrjedhojë, ligjvënësi ka paraparë një model të veçantë organizativ për procedurat e përzgjedhjes në arsimin parauniversitar, i cili përfshin mekanizma profesionale dhe institucionale specifike për këtë sektor.

Për më tepër Gjykata vlerëson se kjo dispozitë rregullon në mënyrë specifike përbërjen dhe themelimin e komisioneve për përzgjedhjen e mësimdhënësve në sektorin e arsimit parauniversitar, duke i dhënë rol të drejtpërdrejtë Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe strukturave të institucionit arsimor, dhe se nga natyra e kësaj dispozite rezulton se komisioni krijohet në funksion të një procedure konkrete për një pozitë të caktuar, çka në praktikë nënkupton komision me karakter të përkohshëm (*ad hoc*). Ndërsa në anën tjetër nga përmbajtja e nenit 21 të rregullores së atakuar rezulton se i njëjti nuk është në harmoni me dispozitën e lartcekur, kjo pasi që sipas legjislacionit në fuqi, përzgjedhja e mësimdhënësve realizohet nga një komision i themeluar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, në përbërje të të cilit përfshihen edhe drejtori i institucionit arsimor dhe përfaqësues të Këshillit Drejtues, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Megjithatë rregullorja e kontestuar parashikon që procesi i përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor të koordinohet dhe drejtohet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e punëdhënësit, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, MASHTI-n dhe AAAPARr-në, duke përjashtuar nga përbërja e komisionit drejtorin e institucionit arsimor dhe përfaqësuesit e Këshillit Drejtues. Rrjedhimisht, rregullorja në fjalë, respektivisht neni 21 i saj rezulton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi ndryshon përbërjen e organit vendimmarrës të përcaktuar me ligj, duke përjashtuar subjekte që ligji i konsideron pjesë përbërëse të domosdoshme të këtij procesi.

Gjykata vlerëson se Ligji për Zyrtarët Publik përbën kornizën e përgjithshme (*lex generalis*) për rregullimin e marrëdhënieve të punës dhe procedurave të rekrutimit në shërbimin publik, ndërsa Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe Ligji për Arsimin në Komuna përbëjnë legjislacion sektorial (*lex specialis*), i cili rregullon në mënyrë më të detajuar dhe specifike çështjet që lidhen me përzgjedhjen dhe emërimin e stafit arsimor. Në rast të ndërthurjes së normave të përgjithshme me norma sektoriale specifike, zbatohet parimi i njohur juridik *lex specialis derogat legi generali*, sipas të cilit norma e veçantë ka përparësi në fushën që rregullon në mënyrë specifike. Si rrjedhojë edhe qëllimi i rregulloreve të nxjerra si akte nënligjore është të zbatojnë dhe konkretizojnë ligjin në praktikë, ato janë akte nënligjore që nxirren për të sqaruar mënyrën se si dispozitat ligjore do të aplikohen në situata konkrete, megjithatë rregulloret nuk mund të kufizojnë ose ndryshojnë të drejta dhe detyrime që janë përcaktuar më ligj, dhe si të tilla nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin.

Në anën tjetër parimi "*lex specialis derogat legi gjenerali*" përcakton se kur një situatë faktike i nënshtrohet dy akteve normative, përparësi i jepet aktit të veçantë mbi aktin e përgjithshëm. Ky parim zbatohet në fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare publike, përfshirë edhe fushën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, siç pasqyrohet në jurisprudencën e Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme e Kosovës, rikujton se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare (neni 16 paragrafi 3) dhe se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 53). Ky parim siguron bazën për t'u dhënë përparësi dispozitave më specifike ligjore ose nënligjore kur lind konflikt midis rregullave të përgjithshme dhe atyre të veçanta, duke respektuar njëkohësisht standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjykata, për vlerësimin e këtij pretendimi, fillimisht i referohet dispozitës përkatëse të Ligjit për Zyrtarët Publik. Neni 81 paragrafi 7 përcakton: "Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë, Komisioni i përzgjedhjes është me mandat dy (2) vjeçar, themelohet nga organi emërues dhe përbëhet nga të paktën pesë (5) anëtarë/ë. Komisioni i përzgjedhjes themelohet për çdo grup apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi." Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezultojnë dy elemente thelbësore: Parimi i përgjithshëm është që komisioni të ketë mandat dyvjeçar dhe të themelohet nga organi emërues. Ligjvënësi ka paraparë shprehimisht një përjashtim me formulimin: "Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë". Kjo klauzolë përjashtuese tregon qartë se vetë Ligji për Zyrtarët Publik e pranon mundësinë që, në sektorë të caktuar, ligje

të veçanta (lex specialis) të rregullojnë ndryshe mënyrën e themelimit dhe përbërjes së komisioneve përzgjedhëse.

Duke pasur parasysh se neni 81 paragrafi 7 i Ligjit për Zyrtarët Publik lejon shprehimisht rregullim ndryshe “*me ligj të veçantë*”, se Ligji për Arsimin Parauniversitar përbën ligj sektorial të veçantë që rregullon në mënyrë specifike përzgjedhjen e stafit arsimor dhe se Rregullorja e kontestuar është akt zbatues i këtyre dispozitave ligjore. Gjykata vlerëson se përcaktimi i komisioneve përzgjedhëse në sektorin e arsimit si komisione të themeluara për procedura konkrete, respektivisht neni 21 i Rregullores së atakuar nuk është harmonizuar me nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, që nënkupton se komisionet për rekrutimin e personelit edukativo – arsimorë nuk janë themeluar në mbështetje të nenit të lartcekur. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimi për paligjshmëri të komisioneve përzgjedhëse është i bazuar.

VII. Vlerësimi i gjykatës mbi pretendimet e kërkesës për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit

Gjykata, ka vlerësuar se paditësi në mbështetje të nenit 25 par.2 të LKA-së, ka legjitimitet për të paraqitur padi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ dhe kërkesë për pezullimin e zbatimit të tij, ndërsa të paditurat kanë legjitimitet pasiv pasi akti është miratuar nga Qeveria dhe zbatohet nga MASHT.

Në vlerësimin e kërkesës për masë të përkohshme, gjykata shqyrtoi nëse janë përmbushur kriteret ligjore për caktimin e saj, veçanërisht ekzistenca e rrezikut për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm. Gjykata konstatoi se paditësi nuk ka arritur të dëshmojë ekzistencën e një dëmi real dhe të drejtpërdrejtë që do të justifikonte pezullimin e aktit normativ.

Përkitazi me domosdoshmërinë e shmangies së një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës: Gjykata ka vlerësuar se, as nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe as nga provat e dorëzuara, nuk është vërtetuar rrethana e shkaktimit të dëmit të rëndë, dhe të pakthyeshëm, nëse nuk caktohet masa e sigurimit. Për këto arsye, gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit, ndonëse lidhen me ligjshmërinë e dispozitave të akteve nënligjore normativ të kontestuara, nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kriteret ligjore për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit. Paditësja nuk ka arritur të dëshmojë ekzistencën e një rreziku real dhe të drejtpërdrejtë për shkaktimin e dëmit të rëndë dhe të pakthyeshëm, ashtu siç kërkohet me nenin 100 paragraf 1 të LKA-së, e as se ndalimi i zbatimit të rregullores do të ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e interesit publik.

Për më tepër, pretendimet e paraqitura kërkojnë një shqyrtim të thelluar të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së aktit normativ, çështje këto që i përkasin vendimmarrjes meritore dhe nuk mund të trajtohen në këtë fazë procedurale pa rrezikuar paragjykimin e çështjes. Në mungesë të provave konkrete dhe bindëse mbi domosdoshmërinë e ndërhyrjes së menjëhershme gjyqësore, gjykata vlerëson se ndërhyrja e përkohshme do të ishte disproporcionale dhe në kundërshtim me parimin e stabilitetit institucional.

Gjykata kishte parasysh balancimin mes interesave të individëve dhe shoqërisë, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe si rezultat arriti në përfundim se dispozitat e kontestuara nuk përmbajnë elemente që do të mund të i atribuoheshin shkakut të ndonjë dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm dhe që si rrjedhojë të mund të kualifikohej si: shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Gjykata konstaton se interesi publik prevalon ndaj interesit individual, andaj, ndërhyrja e përkohshme e gjykatës në këtë fazë do të cenonte rëndë stabilitetin institucional dhe do të krijonte precedent të rrezikshëm për ndërhyrje gjyqësore në politikën administrative. Në këtë drejtim, Gjykata vlerësoi se dispozitat e kontestuara nuk shkaktojnë dëm të rëndë dhe të pakthyeshëm dhe, rrjedhimisht, nuk përbëjnë shkelje të të drejtave themelore të njeriut.

Sipas gjykatës, për caktimin e masës së sigurimit duhet të provohet ekzistenca e një rreziku real dhe të drejtpërdrejtë për dëm të pakthyeshëm, si dhe domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i masës në raport me interesin publik. Ndërsa në mungesë të argumenteve të qarta dhe provave konkrete mbi domosdoshmërinë e caktimit të masës së sigurimit, gjykata vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe rrjedhimisht refuzon kërkesën për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, përkatësisht moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të rregullores.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata refuzoi kërkesën e parashtruar nga pala paditëse për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se në mënyrë proporcionale nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 100 paragraf 1, nën paragraf 1.1 dhe 1.2, në lidhje me paragraf 2 të LKA-së, për tu caktuar një masë e tillë, dhe në mbështetje të nenit 10 paragraf 4 si dhe 60 paragraf 2, LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

VIII. Vlerësimi i gjykatës mbi kërkesat aksesore lidhur me shpenzimet e procedurës

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 101 të LKA-së [Shpenzimet e Procedurës] “1. Pala e cila e humbë procesin

gjqësor, tërësisht, detyrohet të bartë të gjitha shpenzimet gjyqësore, përveç rastit të përcaktuar në nenin 65 paragrafi 6 të këtij ligji. 3. Pa rënë ndesh me paragrafin 1 të këtij neni, administrata e paditur në çdo rast, detyrohet të bartë shpenzimet e veta, pavarësisht nga rezultati i procesit gjyqësor”, andaj duke pasur parasysh rezultatin e procedurës dhe përcaktimet ligjore gjykata vendosi që secila palë t’i bartë vetë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të lartë cekurat, Gjkata Supreme konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, neni 11 paragrafi 3, neni 59, dhe nenin 101 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

P.A.nr.5/2026, datë 23 prill 2026

B. Profesionale

Drilona Kajtazi

Kryetar i kolegjit,

Lumni Sallauka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa (neni 10 paragraf 4 i LKA-së).